




**NEVOJA PËR STANDARDE  
GLOBALE DHE ZGJIDHJET PËR TË  
LUFTUAR FALSIFIKIMIN**



# PËRMBAJTJA

- 1 PAMJA E PËRGJITHSHME**
- 2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**
- 3 PROBLEMI I FALSIFIKIMIT**
- 4 SFIDA E ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT**
- 5 GS1 DHE ROLI I SAJ NË MBËSHTETJE TË ORIGINALITETIT TË PRODUKTIT DHE GJURMUËSHMËRISE SË TIJ**
- 6 KUADRI I VIZIBILITETIT TË GS1**
- 7 KONKLuzionet**

# 1. Pamja e përgjithshme

Qëllimi i këtij dokumenti është të ndërgjegjësojë publikun duke paraqitur rrezikun që kanoset nga falsifikimi dhe tregtimi i paligjshëm i produkteve, si dhe të përshkruajë mënyrën se si standardet dhe shërbimet globale GS1 mund të luajnë një rol jetik në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Ky document paraqet trendet dhe praktikatat kryesore të falsifikimit si dhe përshkruan mënyrat e sigurimit të rrjeteve globale të furnizimit kundër kërcënimeve të mallrave të falsifikuara përmes vizibilitetit, gjurmueshmërisë dhe transparencës më të lartë.

Gjithashtu, ky dokument do të shpjegojë më tej mënyrat se si standardet GS1 mund të ndihmojnë në zvogëlimin e kërcënimeve, duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

- Ç'vlerë do ti shtohet biznesit tuaj nga përfshirja e standarderve dhe shërbimeve GS1 në strategjitë e mbrojtjes së markës?
- Cilat standarde, shërbime dhe zgjidhje janë të disponueshme sot?

Ky dokument do të shërbejë lexuesve për të kuptuar dhe përgjigjur çështjeve të mëposhtme:

- Përshkrimin e standardeve, proceseve dhe teknologjive që identifikojnë në mënyre unike produktet dhe aktivitetet e zinxhirit të furnizimit dhe ofrojnë vizibilitet e gjurmueshmëri më të lartë të produkteve përgjate gjithë proceseve të ciklit “jetesor”.
- Përshkrimin e mënyrës se si qasje të bazuara në standarde mundësojnë krijimin e marrëdhënieve më produktive dhe reciprokisht përfituese mes partnerëve të biznesit nëpërmjet zbulimit të shpejtë të produkteve të pasigurta ose të falsifikuara.
- Përshkrimin e një procesi ndërveprues për identifikimin e vërtetimit e origjinalitetit të produktit.



## 2. Përmbledhja ekzekutive

### Problemi i Falsifikimit

Për të trajtuar problemin në rritje të falsifikimit të produkteve (i cili pritet të shkaktojë një dëm prej 1.77 trilion USD në 2015), është e nevojshme të krijohet një bashkëpunim ndërkombëtar nëpërmjet një qasjeje të qëndrueshme. Kjo qasje konsiston në uljen e rrezikut të falsifikimit nëpërmjet ngritjes së strukturave globale bashkëpunuese mes përfaqesuesve të industrive dhe atyre të qeverisë si dhe implementimin efikas të standardeve në rrejet globale të zinxhirit furnizues.

#### **Falsifikimi rrezikon sigurinë publike, çënon bizneset legjitime dhe dëmton interesat kombëtare:**

Në nëntor 2012, qeveria e Koresë së Jugut mbylli 2 reaktorë nuklearë pasi zbuloi se më shumë se 7,600 pjesë nga 8 furnitorë kishin çertifikatë cilësie të falsifikuar. Dy reaktorët përbëjnë rreth 5% të furnizimit me energji të të gjithë Koresë së Jugut. Pezullimi i tyre do të reduktojë ndjeshëm sasinë e furnizimit me energji që Koreja e Jugut mban rezervë çdo ditë gjatë muajve të dimrit Janar dhe Shkurt.

- Organizata Botërore e Shëndetësisë e sheh falsifikimin e produkteve mjekësore si një rrezik të madh për shëndetin publik.
- Vendet anëtare të G20 kanë parashikuar rreth 3000 vdekje në vit për shkak të konsumimit të produkteve të falsifikuara.
- Bizneset e ligjshme duhet të konkurrojnë me falsifikatorët e tyre në tregjet ndërkombëtare, ndërsa pronarët e markave dhe mbajtësit e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (IPR) duhet të përballen me rreziqe të larta financiare.
- Vendet anëtare të G20 humbasin çdo vit 77.5 trilion USD në të ardhurat tatimore, si dhe pësojnë një kosto të kimit ekonomik prej 25 trilion USD. Rreth 2.5 milionë vende pune janë humbur, duke rritur kështu koston vjetore të mirëqenies.



Në përgjithësi në sytë e opinionit publik, falsifikimi i produkteve është i paqartë dhe shpesh shihet si një krim i padëmshëm, që natyrisht është shumë larg asaj që është e vërtetë. Kjo mungesë vlerësimi dhe rëndësie i rrezikut të falsifikimit inkurajon dhe mbështet akoma më shumë përhapjen e tij. Tre rreziqet kryesore janë:

1. Siguria e konsumatorit rrezikohet përmes ushqimive të falsifikuara, ilaçeve, pajisjeve mjekësore, lodrave, elektronike, alkoolit, duhanit, pjesëve të automobilave etj.
2. Kërcënimi ekonomik ndikon tek bizneset dhe qeveritë - duke shkaktuar ulje të tregut për bizneset e ligjshme dhe duke reduktuar të ardhurat për qeveritë - tvsh, detyrimet dhe taksat e tjera, ndërsa rrit koston për zbatimin e ligjit.
3. Sigurimi Kombëtar vihet në rrezik për shkak të përdorimit të paisjeve ushtarake të falsifikuara.

**Produktet e falsifikuara po arrijnë të depërtojnë në rrjete të furnizimit që konsiderohen të ligjshme dhe mjaft të sigurta.**

Rritja e globalizimit të tregtisë shoqeruar me numrin e ulët të dënimeve ligjore në vende të botës ndaj tregtimit të produkteve të falsifikuara ka inkurajuar rritjen e aktiviteteve falsifikatore të drejtuara nga banda kriminale.

Sistemet eksistuese në zinxhoret e furnizimit nuk kanë aftësi të plotë për të mbrojtur dhe zbuluar falsifikimet e depërtuara përgjate rrjetit të furnizimit. Si rrjedhojë, zgjidhjet globale janë të nevojshme për të adresuar kërcënimet gjithnjë e në rritje të paraqitura nga veprimet kriminale.



# Zgjidhja

GS1 luan një rol kyç në zhvillimin dhe implementimin e standardeve globale për të luftuar falsifikimin. Zgjidhjet për tu perballur me të duhet të jenë të natyrës globale. Këtu vjen në ndihmë GS1 që mundëson përgjigje të menjëhershme për këtë problem në rritje.

GS1 është organizata e vetme jo-fitimprurëse e autorizuar si Agjensi e Lëshimit të Identifikuesve Unik të Produkteve. Ky rol vital është i autorizuar nga Organizata Ndërkombëtare e Standardeve (ISO), e cila ka lëshuar një bllok kodesh tek GS1 (nga 0 në 9). Në përputhje me standardet ISO, asnjë organizatë tjetër nuk mund ti alokohet ky bllok kodesh (identifikuesish unikë).

Si një Agjensi e Lëshimit të Identifikuesve Unik të Produkteve, GS1 ka autorizimin për të identifikuar në mënyrë unike objekte të cilat përfshijnë objekte fizike, njësi logjistike si paletat apo kontenerët, asetet e kthyeshme, vendndodhjet fizike, shërbimet etj. Pas anëtarësimit tek GS1, kompanisë i caktohet "Prefiksi i Kompanisë", numër unik me njohje globale, që shërben si bazë për krijimin e çdo çelësi identifikimi GS1 në mbështetje të operacioneve të biznesit apo të zinxhirit të furnizimit.

Koncepte bazë

- GTIN - Numri Global i Artikullit Tregtar
- GLN - Numri Global i Vendndodhjes
- SSCC - Kodi Serial i Ngarkesës
- GRAI - Identifikuesi Global i Aseteve të Kthyeshme
- GIAI - Identifikuesi Global i Aseteve Individuale
- GSRN - Numri Global i Shërbimit
- GDTI - Identifikuesi Global i Llojit të Dokumentit
- GSIN - Numri Global i Identifikimit të Dërgesës
- GINC - Numri Global i Identifikimit të Dërgimit
- GCN - Numri Global i Kuponit

Në thelb, zgjidhja globale e problemit të falsifikimit fillon nga aplikimi i një shtrese themelore të standardeve të zinxhirit të furnizimit, të pranuar globalisht, të cilat shërbejnë fillimisht për të identifikuar objekte, më pas për të kapur informacion rreth tyre në pikat kyçe të zinxhirit të furnizimit dhe në fund për të shkëmbyer informacionin midis palëve të interesuara.

Skema e vizibilitetit të GS1 i bën bashkë të gjitha këto dhe mundëson këtë bazë të nevojshme identifikuese që lejon organizatat të fokusohen më shumë se si të përdorin informacionin sesa si ta marrin atë. Kjo ndihmon në përmirësimin e bashkëpunimit, gjurmueshmërisë, sigurisë dhe transparencës në zinxhirin e furnizimit.

Një komponent kyç i Skemës së Vizibilitetit që mundëson shpërndarjen në kohë reale të informacionit të zinxhirit ushqimor është aplikacioni standard i quajtur Shërbimi Elektronik Informues i Kodit të Produktit (EPCIS), i cili është industrial dhe teknologjik.

Nga përdorimi i standardeve globale ekzistuese mund të merren përfitime të menjëhershme. Ato mund të përdoren nga pronarët e markave për ti mundësuar informacion klientëve dhe autoriteteve doganore, të cilët do të kenë akses në informacione që mund ti ndihmojnë ata për të identifikuar me saktësi objekte për qëllime të mëtejshme të vërtetimit të autenticitetit.





### 3. PROBLEMI I FALSIFIKIMIT

Falsifikimi ka ndryshuar nga të qënurit gjërësisht i lokalizuar në biznese globale me prodhim masiv, fitime globale, dhe rrjete globale të shpërndarjes. Falsifikimi i objekteve fizike është i pranishëm në çdo shtet dhe virtualisht gjendet në të gjithë sektorët e ekonomisë globale.

Falsifikimet zakonisht janë të rëndomta dhe kjo mund të shfaqë rreziqe serioze shëndetësore dhe sigurie, me një numër vdekjesh rreth 3,000 në vit në shtetet anëtare të G20. Në 2011 Aleanca e Biznesit për Ndalimin e Falsifikimit dhe Piraterisë (BASCAP) në Paris raportoi se falsifikimet dhe tregu pirat po rriten çdo vit me 12%.

Sipas BASCAP falsifikimi dhe pirateria ndikojnë virtualisht në çdo kategori produktesh. Kohët kur falsifikoheshin vetëm mallrat e luksit, CD muzike të paautorizuar apo DVD tashmë kanë kaluar. Sot, falsifikuesit po prodhojnë ushqime të falsifikuara, pije, paisje mjekësore, produkte farmaceutike, mallra elektrike, pjesë avionësh apo strukturash të tjera.

Miliona produkte të falsifikuara po prodhohen dhe dërgohen në të gjithë botën nëpër tregje të zhvilluara, duke depërtuar në zinxhire furnizimi të ligjshme dhe të sigurta. Konsumatorët dhe pacientët janë në rrezik dhe të pasigurt nga produkte të infektuara, ndërkohë qeverive, bizneseve dhe shoqërisë po i vidhen miliona të ardhura nga tatimet dhe vende pune.





## Tendenat e falsifikimit dhe praktikat mashtruese

Falsifikuesit do të përdorin çdo lloj mjeti për të mashtruar autoritetet dhe klientët e tyre.

### Trendet më të aplikuara

- Objekte fizike pa një markë dërgohen veç nga etiketat e tyre, shenjat dalluese dhe paketimi i markës
- Falsifikuesit të specializuar në prodhimin e këtyre etiketave i eksportojnë këto produkte tek disa montues të produktit final.
- Komponentët e falsifikuar dërgohen të ndarë në zonat e tregut të lirë (FTZ) që të montohen në produkt final dhe shpërndahen brenda zonave ose jashtë tyre.
- FTZs përdoren për të fshehur origjinën e falsifikimit.
- Pjesë të ngarkesave origjinale ose paleta mallrash zëvendësohen me ato të falsifikuara.
- Shitjet në internet të mallrave të falsifikuara çojnë në mbetjet stok dhe kthime të shumta të mallrave.
- Shitjet e mallrave të falsifikuara nga konsumatori në konsumator zënë vënd në shitjet online
- Diferencat dhe mangësitë në ligje, rregullore dhe zbatimin e tyre janë marrë si avantazh në parandalimin e proceseve të falsifikimit dhe ekspozimit të falsifikatorëve ndaj pasojave ligjore.

- Në 133,000 paketime të inspektuara nga autoritetet rregullatore, 6,700 u konfiskuan.

- 80 persona janë nën investigim dhe të arrestuar për një sërë shkeljesh, duke përfshirë dhe një laborator të paligjshëm për prodhimin e barnave të falsifikuara, anëtarë të grupeve kriminale që shesin barna të paligjshme online dhe faqet e internetit që ata shesin.

Përdorimi i standardeve të GS1 konsiston në ndërtimin e një niveli bazik besimi ndërmjet blerësve dhe shitësve online. Besimi ndërtohet mbi burime të verifikuara informacioni për shitësit, produktet dhe metodat për vërtetimin e produkteve të marra nga blerësi.



## 4. SFIDAT NË ZINXHIRIN E FURNIZIMIT

### ZINXHIRI I FURNIZIMIT

Zinxhiri aktual i furnizimit në shumë sektorë nuk është i përshtatshëm për të përballuar sfidën e problemit të falsifikimit. Mangësitë janë për shkak të faktit se proceset aktuale të zinxhirit të furnizimit janë të bazuara në sisteme të trashëguara, që më përpara mbaheshin të dokumentuara. Edhe pse janë adoptuar barkodet ose teknologjia EDI, zgjidhjet e implementuara nuk kanë përfshirë standarde globale për identifikimin unik të objekteve ose gjurmueshmërinë si komponentë thelbësorë. Për këtë arsye transparenca në zinxhirin e furnizimit nuk është në nivelin e duhur.

Fakt, që e mbështet atë që u përmënd më sipër, është mangësia në tërheqjen e mallrave të dëmtuara nga tregu të kompanive prodhuese. Kërkimet zbuluan se 67% e kompanive prodhuese ushqimore me 5 miliarde USD shitje kanë tërhequr mbrapsht produktet e tyre që kishin një kosto prej 20 milion USD. U deshën mesatarisht 42 ditë për të përmbyllur procesin e tërheqjes së produkteve nga tregu dhe ata arritën të lokalizonin vetëm 43% të produkteve në kategoritë më të rëndësishme. Produktet e falsifikuara janë shkak tërheqjes mbrapsht të produkteve duke bërë që të ketë më shumë nevojë për transparencë në zinxhirët e furnizimit, në mënyrë që të bëhet identifikimi i objekteve dhe të luftohet ky fenomen.



GS1 dhe industria punuan në zgjidhjen e këtij problemi dhe në Qeshor të 2012 u ratifikua një standard global për produktet e tërhequra nga tregu. Shërbimi i njoftimit online të tërheqjes së produkteve, i aplikuar nga Organizatat e GS1 në industrinë e ShBA, Kanadasë, Australisë, Zelandës së Re dhe Afrikës së Jugut, redukton kohën e komunikimit të tërheqjes së produkteve dhe mundëson alarmin e sigurisë për të gjitha palët në zinxhirin e furnizimit, përfshirë dhe organet shtetërore në më pak se 1 orë. Të gjitha standardet të bëra bashkë, zvogëlojnë rrezikun për bizneset dhe konsumatorin.

## Gjetja e një zgjidhje nga kompania nuk funksionon

Në vitet e fundit janë zhvilluar shumë llojë zgjidhjesh të izoluar nga vetë kompanitë për identifikimin e objekteve dhe autenticitetin e tyre. Ata nuk kanë ndërveprimin e nevojshëm për të siguruar se të gjitha palët e interesuara të zinxhirit të furnizimit mund ti implementojnë këto zgjidhje.

Në veçanti, që të jetë efektiv në të gjithë zinxhirin e furnizimit është e nevojshme që të gjitha palët të kenë një standard të përbashkët global në identifikimin e produkteve dhe ndarjen e informacioneve, i cili mund të menaxhohet lehtë në sistemin e brendshëm të tyre dhe me partnerët tregtarë.

Duke qënë se nuk ka një metodë të veçantë për të garantuar identifikimin dhe autenticitetin e objekteve fizike në industri, identifikimi unik i produkteve një kërkesë parësore në sektorët e industrisë. Por këto janë komponentë të një strategjie më të gjërë të mbrojtjes së markës.

## Çfarë nevojitet për ta ndërmarrë këtë sfidë?

Përgjigja është përmirësimi i transparencës në zinxhirin e furnizimit dhe zgjidhje të bazuara në standarde globale, ndërvepruese që lehtësojnë shtrirjen e tyre dhe ulin kostot e implementimit.

Fatmirësisht sistemi identifikues i GS1 përfshin identifikimin unik të produkteve, aseteve, vendndodhjeve dhe gjithashtu standardeve për të kapur dhe shpërndarë informacion mes partnerëve në zinxhirin e furnizimit.

Ky nivel themelor i standardeve të identifikimit është i përshtatur në mënyrë ideale që të mbështesë zgjidhjet e nevojshme për të pasur një zinxhir furnizimi të sigurt dhe për të mundësuar mjetet e duhura për identifikimin dhe autentifikimin e një objekti në kohë reale. Kështu sigurohet që falsifikimet të mund të sinjalizohen përpara se të shkaktojnë dëme te konsumatorët, bizneset apo interesa të tjera kombëtare.




## Zinxhirë furnizimi të sigurt

Zhvillimi dhe implementimi i zinxhirëve të sigurt të furnizimit është kritik jo vetëm për të zvogëluar rrezikun e falsifikimit, por edhe për të rritur besimin dhe transparencën mes partnerëve me njëri tjetrin. Themelet e ndërtimit të një zinxhiri të sigurt dhe transparent mund të vendosen efektivisht duke implementuar Strukturën e Vizibilitetit të GS1.

Struktura e Vizibilitetit të GS1 merr një qasje gjithëpërfshirëse duke u bazuar në aspektet kryesore të theksuara në figurën më poshtë dhe përfshin menaxhimin në kohë reale të asaj që ndodh me produktin.



## Struktura e një zinxhiri të sigurt furnizimi



## Përdorimet në industri:

Udhëheqësit për Medikamentet e Falsifikuara të BE-së, të cilët kërkojnë zinxhirë furnizimi më të sigurt për shpërndarjen e barnave me receta, kërkojnë serializimin e paketave të pacientëve, gjithashtu dhe etiketa të qarta për të siguruar autenticitetin e barnave. Federata Europiane e Shoqatave të Industrisë Farmaceutike (EFPIA) ka zhvilluar një program pilot të suksesshëm bazuar në identifikimin automatik të produkteve, të standardeve të kapjes së të dhënave nga GS1, gjithashtu dhe në përdorimin e EPCIS për krijimin dhe funksionimin e një baze të dhënash që i mundëson një shitësi në farmaci të kontrollojë autenticitetin e barnave përpara se t'ja ofrojë pacientit.

Një shembull praktik i transparencës së një zinxhiri furnizimi po funksionon që nga 2005 dhe ka vërtetuar aftësitë për të ruajtur autenticitetin e një produkti dhe gjithashtu ka siguruar tërheqjen mbrapsht të produkteve në qindra vendndodhje në më pak se 10 minuta.



## Identifikimi i objektit – Cili objekt dhe çfarë është?

### Identifikimi i produkteve të konsumatorit dhe shitjet:

Në nivelin e shitjeve, procesi i verifikimit të një objekti si produktet e konsumit duhet të fillojë me inspektimin fizik dhe vizual të tij. Paketimi, prania e logos së markës në këtë paketim dhe prania e barkodit në etiketë janë elementë shumë të rëndësishëm për të ndihmuar në procesin e verifikimit. Një konsumator normalisht duhet të pyesë shitësin për produktin përpara se ta blejë atë.

Në blerjet online, ky proces nuk është gjithmonë i mundur dhe konsumatorit mund ti duhen mjete të tjera për të verifikuar identitetin dhe autenticitetin e produktit. Një konsumator duhet gjithmonë të mundohet të kontaktojë pronarin e markës nëpërmjet një website ose shërbimi klienti në qoftë se lindin dyshime për produktin.

Sot ekzistojnë shumë faqe interneti dhe aplikacione smarphonë-sh që mundësojnë informacion për produkte si p.sh përshkrimi i produktit, vlerat ushqyese, çmimi etj. Sidoqoftë, shumë nga këto burime mund të mos jenë të lidhura me të dhënat direkte të produktit të ofruara nga kompania. Studimet e fundit kanë treguar se saktësia e skanerave nëpër telefona për informacione mbi produktin është shumë e ulët. GS1 po bashkëpunon me industrinë për të zgjidhur këtë problem nëpërmjet GS1 Source.

GS1 Source është një strukturë e bazuar në standarde, e përshkallëzuar dhe ndërvepruese e cila shërben për shpërndarjen e informacionit në kanale dixhitale të konsumatorëve. Kompanitë mund ta përdorin GS1 Source për të shpërndarë informacione për produktet e tyre nëpër cloud-e. Ndërtuesit e aplikacioneve, më pas mund të integrojnë të dhënat e produkteve në faqet e internetit dhe në aplikacionet telefonike. Në 2012 GS1 ratifikoi standardin Trusted Source of DATA (Burimi i Besueshëm i të Dhënave-TSD).

### Identifikimi i objekteve për konsumatorit dhe mbikqyrësit e tregut:

Në qoftë se një agent i mbikqyrjes së tregut ka nën inspektim një sërë produktesh, kutish apo paletash, ai duhet të marrë informacion për produktin dhe për dërgimin e tyre. Kjo bëhet duke përdorur GEPIR (Regjistri Elektronik i të Dhënave Globale të Produktit). GEPIR është unik dhe funksionon nëpërmjet shërbimit të internetit. Ai jep akses për informacione bazike për kompanitë që janë anëtarë të GS1. Këta anëtarë e përdorin këtë sistem për të identifikuar produktet e tyre ose vendndodhjen fizike gjatë dërgesave të ndryshme. Duke përdorur informacionin në GEPIR, çdo njeri mund të gjejë pronarin e ligjshëm të një barkodi. Arsyet pse identifikuesit e objekteve nuk shfaqen në GEPIR janë:

- Futja gabim e të dhënave të identifikimit të produktit.

- Përdorimi jo i ligjshëm i identifikuesve nga kompanitë duke përdorur sistemin e GS1 ndërkohë që nuk janë të antarësuar.
- Vendosja e identifikuesit të objekteve në etiketa sekondare të objektit ose në pako e cila realizohet nga importues që nuk janë të regjistruar në GS1.
- Faqet e internetit të kompanive apo shërbimi i klientit duhet të kontaktohen sa më shpejt në rast se dyshohet në identitetin e një objekti fizik gjatë inspektimit. Pronarët e markave në përgjithësi kanë disa marka brenda portofolit të tyre.

Standardet GS1 përcaktojnë dhe GCPC (Kodi Global i Klasifikimit të Produktit). GCPC është një sistem klasifikimi i bazuar në rregulla dhe i strukturuar në mënyrë që ti japë blerësve dhe shitësve një gjuhë të përbashkët për grupimin e produkteve në të gjithë botën.

GCPC është një instrument i paçmueshëm për pronarët e markave që të kategorizojnë, regjistrojnë dhe shpërndajnë të dhënat me të gjithë partnerët tregtarë. Gjithashtu mund të përdoret nga inspektorët e tregut për të verifikuar identitetin e produkteve dhe nga doganat për vlerësimin e rrezikut para importit.



## Autenticiteti i objekteve – A është i vërtetë?

Pronarët e markave mund të nxjerrin aplikacione të ndryshme dhe instrumente specifike si qëllim autentifikimin e një produkti. Pas verifikimit të identitetit të objektit, hapi tjetër është përcaktimi nëse produkti është i vërtetë.

Autenticiteti ose vërtetësia e një objekti do të varet nga ai që inspekton objektin, njohuritë e tij për produktin dhe procedura e autentifikimit. Inspektuesi mund të ketë akses të limituar në informacion ose mund të informohet në mënyrë shumë të detajuar, në varësi të vlerës së objektit dhe qëllimeve të përdorimit të tij.

**Konsumatorët** : një konsumator është në rolin e një inspektori dhe do mbështetje në njohuritë e tij për produktin dhe në inspektimin vizual për të verifikuar vërtetësinë e produktit që po blenë. Konsumatorët zakonisht i besojnë shitësit ku ata blejnë për sigurinë dhe autenticitetin e produktit.

**Doganat ose inspektuesit e tregut**: në këto role, doganat ose inspektuesit e tregut mund të kenë akses në burime informacioni konfidenciale, zakonisht portale konfidenciale që listojnë dhe përshkruajnë strategji të ndryshme për mbrojtjen e markave. Strategjitë për mbrojtjen e markës kanë mjete verifikimi të shumëllojshme që kërkohen për të verifikuar vërtetësinë e një objekti.

**Pyetjet kryesore për inspektuesit e tregut**: A kanë produktet pengesa të fshehta ose të dukshme që vërtetojnë autenticitetin e tyre? Kush është burimi i autorizuar për të verifikuar autenticitetin e produktit?

### Mjete të jashtme

Të vendosura për qëllime primare

Sensorë

- Të dukshëm
- Të fshehur
- Mjeko-ligjore

Mjete dixhitale

- Serializimi i produkteve # (SGTIN)
- Identifikimi i produkteve # (GTIN)

### Mjete të brendshme

Elementë funksionale dhe estetikë të produktit jo për qëllime parësore.

Përfshihen :

- Materiale specifike
- Karakteristika unike të strukturimit
- Bashkimi

### Autentifikimi hibrid

Kombinimi i mjeteve dixhitale dhe atyre të brendshme dhe të jashtme për qëllim mbrojtjen e markës.

Përfshihen:

- GTIN + karakteristika mjeko-ligjore
- GTIN + shenja të dukshme, etiketa ose hologramë
- GTIN + karakteristika të brendshme dhe markë e fshehur
- GTIN + karakteristika të fshehura

# Ndërtimi i shërbimeve ndërvepruese të autenticitetit

Me rritjen masive të falsifikimeve në të gjithë sektorët e industrisë, ka një rritje të zgjidhjeve të mundshme që luftojnë këtë fenomen nga vetë kompanitë. Nevoja për ndërveprim është e ditur dhe GS1 ka marrë pjesë në komitetin teknik të ISO dhe ka punuar për draftin e parë në 2013.


Çelësi për të mundësuar ndërveprim është standardi global dhe infrastruktura globale për ta mundësuar atë.

Standardi ONS (Shërbimi i Emërtimit të Produktit) lehtëson nevojën për ndërveprim të shërbimeve të autentifikimit.

ONS ofron një strategji pragmatike dhe fleksibël për këtë nevojë. Ofruesit ekzistues të zgjidhjeve mund të konkurrojnë dhe të avancojnë me shërbimet e tyre nëpërmjet mundësisë që jep ONS për ndërveprim.

Pronarët e markave kanë kontroll të plotë të shërbimeve të tyre duke përfshirë të drejta dhe privilegje, siguri dhe plotësim të nevojave të përdoruesve. Shërbimi i vendosur nga ONS mund të përdoret në listat e zeza, si një regjistruar për kodet identifikuese të falsifikuara duke e bërë më të thjeshtë kapjen e falsifikimeve.

Në përgjithësi, ONS ka të bëjë me të dhëna dhe shërbime të besueshme, të lidhura me çelësat e identifikimit të GS1. Me pak fjalë, një çelës identifikues siç është GTIN, SGTIN ose EPC mund të përdoret për të kontrolluar të dhëna dhe shërbime të konfiguruar nga kompanitë. Ky mund të jetë një mjet i fuqishëm për të gjithë palët e interesuara në zinxhirin e furnizimit, duke përfshirë prodhuesit, distributorët, importuesit, doganat, shitësit madje dhe për vetë konsumatorët.





## 5. GS1 DHE ROLI I SAJ PËR MBËSHTJETJEN E SISTEMEVE TË AUTENTIFIKIMIT DHE GJURIMIT TË PRODUKTEVE

Sistemi GS1 është një tërësi e integruar standardesh dhe shërbimesh që i mundëson organizatave të të gjitha llojeve një gjuhë të përbashkët, duke i bërë ato të komunikojnë dhe ndërveprojnë lehtësisht ashtu sic bëjnë dhe në biznes. Standardet GS1 janë më të përdorurat dhe më të besuarat në zinxhirin e furnizimit në të gjithë botën dhe përfshijnë barkode që gjenerojnë mbi 6 milion alarme në pikat e shitjes kudo nëpër botë.

Standardet GS1 luajnë një rol të rëndësishëm në mundësimin e lidhjeve që ndërtojnë besim dhe transparencë për partnerët e biznesit në të gjithë botën, nga prodhimi i lëndës baze deri tek konsumatori.

Duke adoptuar standardet e GS1 si bazë për proceset e biznesit të tyre, kompanitë mund të flasin një gjuhë të përbashkët dhe të rrisin nivelin e informacionit në të mirë të biznesit të tyre. Industri te ndryshme janë të afta të adoptojnë dhe implementojnë lehtësisht standardet e GS1 për të transformuar mënyrën e tyre të të bërit biznes, duke ndjekur hapat e liderëve të industrisë që tashmë kanë zhvilluar zbatimet më të mira në industri.

Standardet globale GS1 për identifikimin e produkteve, vendndodhjeve dhe ndarjen e të dhënave që lidhen me njëri tjetrin duhet të jenë baza e strategjive për mbrojtjen e markës dhe luftimin e falsifikimeve për një kompani.

Standardi GS1 i Gjurmueshmërisë përcakton se si industritë duhet të gjurmojnë të gjitha produktet që nga lënda bazë e deri tek produkti final.





## 6. STRUKTURA E TRANSPARENCËS SË GS1

Struktura e Transparencës së GS1 i bën të mundur organizatave të fokusohen më shumë në mënyrën se si ta përdorin informacionin sesa si ta marrin informacionin. Kjo ndihmon në përmirësimin e bashkëpunimit, transparencës, efektivitetit, dhe sigurisë së zinxhirit të furnizimit. Një komponent kyç i kësaj strukture që mundëson shpërndarjen e informacionit në kohë reale është standardi i quajtur Shërbimi Elektronik Informues i Kodit të Produktit (EPCIS). Ai është i krijuar dhe i projektuar nga industria për t'ju përshtatur ndërmarrjeve ekzistuese dhe sigurisë mjedisore, duke plotësuar sistemet e informacionit për kompanitë ekzistuese. Ky standard redukton ndërlikimet dhe kostot e integritetit të sistemit dhe ndërkohë lehtëson bashkëpunimin mes partnerëve tregtarë.

EPCIS i mundëson partnerëve në zinxhirin e furnizimit të ruajnë dhe të ndajnë me njëri tjetrin të dhëna për ngjarje fizike si : çfarë, kur, ku, dhe pse në lidhje me vëzhgimet fizike.

Kjo i lejon kompanive që të bashkohen dhe të ndajnë me njëri-tjetrin të dhëna në lidhje me identitetin e një objekti. P.sh. kompanitë mund të lidhin informacione si ora dhe data kur një barkod është skanuar, vendndodhjen nga ku u


skanua dhe nqs objekti po dërgohet apo po merret. Informacione të tjera lidhur me objektin mund të jenë temperatura, porositetë e blerjes dhe arsyet e lëvizjes së këtij objekti. Ky informacion shtesë mund ti lidhet një database të EPCIS. Duke pasur informacione kaq të detajuara, organizatat përfitojnë vizibilitet në kohë reale të objekteve brenda kompanive dhe në të gjithë zinxhirin e furnizimit. Në këtë mënyrë mund të kuptohen qartë përfitimet e auto-identifikimit, duke përdorur informacionet e marra.



## Skema e Vizibilitetit të GS1: Identifiko, Lexo, Shkëmbe

### IDENTIFIKO: Standardet GS1 për të identifikuar

GLN Global Location Number GTIN Global Trade Item Number SSCC Serial Shipping Container Code GRAI Global Returnable Asset Identifier GIAI Global Individual Asset Identifier GSRN Global Service Relation Number



### LEXO: Standardet GS1 për barkode dhe EPC/RFID

GS1 BARCODES

GS1 EPC/RFID



### SHKËMBE: Standardet GS1 për shkëmbimin e të dhënave

MASTER DATA Global Data Synchronisation Network (GDSN) TRANSACTIONAL DATA eCom (EDI) EVENT DATA EPC Information Services (EPCIS)




Më poshtë tregohet një shembull i Skemës së Vizibilitetit të GS1 duke përdorur EPCIS në Hong Kong. Ky shërbim i mbrojtjes së markës kombinon elementët Identifikim -Lexim - Shkëmbim si dhe shërbimet e Origjinës dhe Autentifikimit të objektit. Në Hong-Kong u implementua në 2017 me ndihmën dhe financimin e industrisë dhe qeverisë. Në këtë process model u krijuan kode seriale të identifikimit të objektit (ngjarja 1).

Këto identifikues serial më pas u lidhën me bazën e të dhënave të objektit, që përshkruajnë produktin dhe hyjnë në Shërbimin GS1 Hong Kong PA. “Ngjarja 2” vë në dukje se ku mundësohen etiketa të sigurta dhe numra serialë të autentifikimit për fabrikuesin nga pala e tretë që është kompania e etiketave.

Më poshtë është përgjigja e kërkuar duke përdorur aplikacionin për smartphone “GS1 Hong-Kong Consumer Connect”

### Skema e Vizibilitetit





## 7. KONKLUZION

Rritja e aktivitetit të falsifikimit në të gjithë sektorët paraqet një sfidë të madhe për industrinë dhe organet shtetërore në të gjithë botën. Falsifikimi nuk është krim pa viktima përkundrazi ai mund të ketë pasoja direkte tek qytetarët dhe industria.

Një nga shkaqet kryesore se pse falsifikimi është rritur, është paaftësia e sistemeve aktuale të zinxhirit të furnizimit për tu përballur me këtë krim. Përgjigja gjendet tek një vizibilitet, transparencë dhe gjurmueshmëri më e mirë në të gjithë zinxhirin ushqimor, nga linja e prodhimit deri në pikat e shitjes.

Fatmirësisht GS1 dhe shërbimet e saj, të cilat bazohen në standard, janë të afta të mbështesin industrinë dhe organet shtetërore për të vënë në zbatim zgjidhje më efektive për problemin e falsifikimit.

Koha për të vepruar është tani! Implementimi i Standardeve GS1, si një bazë themeli, është një pikë fillimi shumë efiçente për të reduktuar rreziqet e kanosura nga falsifikimi.